SEKRETARI FEDERATIV PER PUNET
E JASHTME I REPUBLIKES SOCIALISTE
FEDERATIVE TE JUGOSLLAVISE

Beograd, 29 maj 1987

I nderuari shoku minister,

Kam kenaqesine qe t'Ju drejtohem dhe te shkembej me Ju mendime mbi rruget e mundshme per forcimin e atmosferes se mirekuptimit dhe besimit reciprok dhe te pasurimit te bashkepunimit dypalesh e shumepalesh, me qellim qe te zhvillohen marredheniet e fqinjesise se mire te vendeve ballkanike.

Me lejoni te nenvizoj se ketij interesi te natyrshem dypalesh dhe shumepalesh te te gjitha vendeve te gadishullit tone i eshte kushtuar vemendja e duhur ne te gjitha takimet dhe bisedimet e deritanishme dypaleshe te personaliteteve me te larta shteterore te vendeve tona. Keto takime dhe bisedime kane qene nje inkurajim per te kerkuar forma me te pershtatshme dhe gjeresisht te pranueshme, te cilat do te na lehtesonin te gjithe neve dhenien e kontributit real per zhvillimin e marredhenieve nderballkanike dhe te bashkepunimit me te mire ne kete pjese te Evropes. Duke patur parasysh se eshte gjithnje i pranishem procesi i mbledhjeve dhe bashkepunimit mbi baza rajonale, si ne Evrope ashtu edhe ne pjese te tjera te botes, ky kontribut do te ishte akoma me i vlefshem sepse vjen nga nje rajon i rendesishem, ne te cilin, si fqinje jetojne dhe zhvillohen perkrah njeri-tjetrit vende qe i perkasin

REIS MALILE
MINISTER I PUNEVE TE JASHTME
TE REPUBLIKES POPULLORE SOCIALISTE
TE SHQIPERISE

grupimeve te ndryshme politike dhe te tjera, si dhe ato qe jane jashte tyre. Ne rajonin tone, kjo i jep bashkekzistences paqesore aktive, nevojes se respektimit dhe besimit reciprok si dhe zhvillimit te gjithanshem te bashkepunimit, nje force imperative dhe mund te veproje si nxitje per marredhenie me te mira te teresishme ne Ballkan dhe ne Evrope.

I nxitur nga te gjitha keto, deshiroj te propozoj qe te mbahet ne Jugosllavi, ne kohen me te afert, mundesisht deri ne fund te ketij viti, nje mbledhje e ministrave te Puneve te Jashtme te vendeve ballkanike, gje te cilen do ta percaktonim ne marreveshje te gjitha vendet ballkanike. E theksoj se ky do te ishte i pari takim i tille ne teresine e marredhenieve te vendeve ballkanike.

Mbledhja e ministrave te Puneve te Jashtme mund te organizohej ne nje forme te pranueshme per te gjitha vendet, te cilen, shpresoj, do ta percaktojme gjate konsultimeve qe po i fillojme me kete leter. Kete mbledhje e mendojme si shkembim mendimesh mbi rruget dhe perspektivat e zhvillimit te bashkepunimit shumepalesh te vendeve ballkanike, pa nje rend dite te percaktuar ne menyre te prere, ne te cilin nuk do te miratoheshin dokumente zyrtare. Qellimi eshte qe ketij bashkepunimi t'i jepet nje impuls ne te gjitha fushat ku perputhen interesat e te gjitha vendeve dhe nevojat jane te perbashketa. Natyrisht, gjithe kjo behet per zhvillimin e bashkepunimit te gjithanshem e te barabarte, per forcimin e paqes, stabilitetit dhe sigurimit ne Ballkan. Nje bashkepunim i tille, ne frymen e respektit dhe mirekuptimit reciprok, ne baze te parimeve te Kartes se OKB-se dhe te parimeve qe permbahen ne Aktin perfundimtar te Helsinkit, do te ishte ne interesin e te gjitha vendeve ballkanike. Ky, padyshim, do te ishte nje kontribut per forcimin e fqinjesise se mire, te marredhenieve dypaleshe dhe shumepaleshe te vendeve ballkanike, per njohjen reciprokisht nga afer te pikepamjeve dhe synimeve qe çojne drejt ketij qellimi. Jam i bindur se nje

mbledhje e tille, me atmosferen dhe orientimin e saj te pergjithshem, do te ishte nje impuls i çmuar edhe per aktivitetet ekzistuese ne fushat konkrete te bashkepunimit multilateral te vendeve ballkanike, ku tashme jane arritur rezultate te rendesishme.

I nderuari shoku minister, do t'u isha shume mirenjohes per idete dhe sugjerimet Tuaja lidhur me propozimin qe u kam parashtruar dhe qe perpunimi dhe percaktimi i te cilit duhet te jete rezultat i konsultimeve, marreveshjeve dhe kontributeve te vazhdueshme te te gjithe pjesemarresve. Per kete qellim propozoj qe per te gjitha tratativat e metejshme te jemi ne kontakt nepermjet ambasadoreve te vendeve tona.

Perfitoj nga rasti, i nderuari shoku minister dhe i dashuri koleg, qe t'Ju dergoj edhe me kete rast shprehjen e respektit tim te thelle, i bindur ne domosdoshmerine e perpjekjeve te metejshme dypaleshe me qellim te zhvillimit te marredhenieve miqesore e te fqinjesise se mire si dhe te bashkepunimit gjithnje me te gjere midis te dy vendeve tona.

Me respekt

Raif Dizdareviç

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME
M I N I S T R I

Tirane, me 15 tetor 1987

I nderuari Zoti Minister,

Kam nderin t'Ju ve ne dijeni se studiova me vemendje letren Tuaj te dates 29 maj 1987 si dhe shpjegimet plotesuese te dhena nga ana Juaj ne takimin qe patem se bashku me 1 tetor 1987 ne OKB, lidhur me propozimin per mbajtjen e nje mbledhje-je te ministrave te puneve te jashtme te shteteve te Ballkanit.

RPS e Shqiperise ka qene dhe eshte gjithmone per krijimin e atmosferes se mirekuptimit dhe te besimit reciprok midis vendeve te rajonit te Ballkanit si dhe per zhvillimin e marredhenieve te fqinjesise se mire midis tyre. Ajo ka per-krahur ato veprimtari nderkombetare, duke perfshire edhe ballkanike, qe i kane sherbyer forcimit te miqesise midis popujve, ashtu siç ka kundershtuar çdo veprim qe ka synuar te largoje vemendjen e popujve nga problemet konkrete qe i shqetesojne ato dhe nderlikojne me tej situatat.

Duke u nisur nga sa thashe me siper, Qeveria shqip-tare vendosi te marre pjese ne mbledhjen e ministrave te puneve te jashtme te shteteve te Ballkanit, qe Ju keni pro-pozuar.

Nga ana shqiptare nuk do te mungoje deshira dhe perpjekjet qe ky takim i rendesishem te kontribuoje ne per-miresimin dhe zhvillimin e marredhenieve dypaleshe dhe

SHKELQESISE SE TIJ
ZOTIT RAIF DIZDAREVIÇ
SEKRETAR FEDERATIV PER PUNET E JASHTME TE
REPUBLIKES SOCIALISTE FEDERATIVE TE JUGOSLLAVISE

B E O G R A D

shumepaleshe te vendeve te Ballkanit, ne forcimin e atmosferes se mirekuptimit, fqinjesise se mire dhe miqesise midis popujve te gadishullit.

Me qellim qe takimi i ministrave te puneve te jashtme te Ballkanit te jete sa me i dobishem e i frytshem, ne mendojme se ai duhet te kete nje rend dite te percaktuar mire qe do te evitonte venien e mbledhjes para veshtiresish te ndryshme.Do t'Ju isha mirenjohes ne qofte se do te me benit te njohur mendimet perfundimtare per rendin e dites dhe procedurat e mbledhjes.

Eshte e kuptushme se nje mbledhje si ajo qe propozohet nga ana Juaj, kerkon nje pergatitje te kujdesshme ne menyre qe te zhvillohet ne nje fryme konstruktive e te perfundoje me rezultate pozitive konkrete.

Ne pritje te sqarimeve Tuaja te metejshme, perfitoj nga rasti per t'u derguar Juve, Zoti Minister, shprehjet e konsiderates time te larte.

Reis MALILE

Minister i Puneve te Jashtme te
Republikes Popullore Socialiste te Shqiperise

Perkthim jo zyrtar
Beograd, me 28 dhjetor 1987

I nderuar shoku Minister,

Eshte nje kenaqesi e veçante per mua qe te mund t'ju informoj me anen e kesaj letre se kam marre pergjigjet e letres sime te 29 majit 1987 nga ministrat e Puneve te Jashtme te Republikes Popullore Socialiste te Shqiperise, te Republikes Popullore te Bullgarise, te Republikes se Greqise, te Republikes Socialiste te Rumanise dhe te Republikes se Turqise, ku me thuhej se ata pranonin iniciativen per te mbajtur ne Beograd mbledhjen e ministrave te Puneve te Jashtme te vendeve ballkanike. Kam pra nderin dhe kenaqesine e veçante t'ju drejtoj me anen e kesaj letre ftesen zyrtare per te marre pjese ne mbledhje ne fjale.

Siç kam patur rastin t'ju ve ne dijeni, konsultime thelbesore jane bere me gjithe vendet ballkanike lidhur me pergatitjet me te efektshme te mbledhjes. Ne kete mision mendimet tuaja mbi rruget qe mund te kontribuojne me mire ne suksesin e mbledhjes ishin shume te çmuara per mua.

Gezohem qe mund te theksoj se u manifestua nje marreveshje e plote gjate konsultimeve per konceptimin, permbajtjen dhe karakterin e mbledhjes dhe pikerisht qe kjo mbledhje ka per objektiv nje shkembim mendimesh mbi rruget dhe mundesite e zhvillimit te vazhdueshem te bashkepunimit shumepalesh midis vendeve ballkanike ne fushat ku kjo eshte realisht e mundur. Pozita ishte gjithashtu e njejte per ate qe mbledhja ka per objektiv te inkurajoje politikisht bashkepunimin shumepalesh ne Ballkan dhe qe shkembimi i mendimeve duhej te behej

Shokut Reis Malile
Minister i Puneve te Jashtme te
Republikes Popullore Socialiste te
Shqiperise
T i r a n e

per kete gje. Pozita fillestare ishte e perbashket: zhvillimi i bashkepunimit shumepalesh ne te gjithe planet eshte ne interesin e forcimit te paqes, te stabilitetit dhe te sigurimit, dhe si rrjedhoje e nje besimi me te madh ne Ballkan dhe ne rajonin e Evropes e marre ne nje kuptim me te gjere. Nje bashkepunim i tille i bazuar mbi respektin dhe mirekuptimin reciprok, ne frymen e parimeve te Kartes se Kombeve te Bashkuara dhe te Aktit Perfundimtar te Helsinkit eshte ne interes te te gjithe vendeve ballkanike.

Shpresoj, i nderuar koleg, se Ju jeni i te njejtit mendim me mua se eshte nje fakt inkurajues per ne te gjithe qe qysh ne kete faze te pergatitjeve dhe te konsultimeve, shume ide dhe sugjerime te dobishme jane bere per bashkepunimin shumepalesh ne fushat e marredhenieve ekonomike, ne veçanti te tregtise, te bashkepunimit dhe specializimit industrial, ne energjetike, transportet, bujqesine, turizmin, ekologjine, shkencen dhe teknologjine, kulturen dhe sportin. Eshte e sigurte se edhe ne mbledhje do te paraqiten ide te reja po aq sinjifikative dhe te cilave ne do t'u kushtojme, jam i bindur, vemendjen tone dhe do t'u japim mbeshtetjen tone politike te perbashket, gjate shkembimeve te mendimeve ne kete mbledhje.

Mbas konsultimeve politike qe jane bere dhe renies dakord lidhur me konceptimin, permbajtjen dhe objektivat e mbledhjes se ministrave te Puneve te Jashtme te vendeve ballkanike rendi i dites eshte formuluar si me poshte:

"Shkembim mendimesh lidhur me idete, rruget dhe mundesite per zhvillimin e nje bashkepunimi shumepalesh ne Ballkan ne te gjitha fushat ku interesat e vendeve ballkanike perputhen dhe ku nevojat jane te perbashketa".

Me lejoni te nenvizoj bindjen e pergjithshme se ky rend dite, i formuluar ne menyre kaq fleksibel dhe qe i kushtohe

nje teme te percaktuar, perfaqeson nje kuader me gjeresi te mjaftueshme qe i lejon çdo vendi te paraqese mendimet e veta mbi marredheniet ne Ballkan dhe idete mbi menyren per te zhvilluar dhe nxitur ne menyre me te gjere bashkepunimin shumepalesh midis vendeve ballkanike, duke patur parasysh nevojat dhe mundesite e natyres politike, ekonomike, kulturore, humanitare, etj., ku interesat e vendeve ballkanike jane te perbashketa. Konsultimet e bera kane arritur ne nje pikepamje te perbashket se mbledhja nuk ka per objektiv te shqyrtoje problemet e marredhenieve dypaleshe midis vendeve ballkanike, sepse shqyrtimi i ketyre çeshtjeve jashte kuadrove dypaleshe nuk do te çonte as ne zgjidhjen e problemeve, as ne objektivin kryesor, as ne perfundimin me sukses te mbledhjes. Per mendimin tone mbledhja e efektshme eshte nje kontribut per vendosjen e nje klime pozitive per te cilen ne aspirojme, te bindur per krijimin e kushteve paraprake te nevojshme per nxitjen e bashkepunimit shumepalesh si dhe te marredhenieve dypaleshe, te frymezuara nga fqinjesia e mire e vendeve ballkanike.

I nderuari Shoku Minister, ka mbizoteruar gjithashtu pikepamja sipas se ciles mbledhja mund te behet ne Beograd nga 24 deri me 26 shkurt 1988. Nepermjet ambasadorit tuaj ne Beograd ju do te informoheni brenda nje kohe sa me te shkurter per çeshtjet lidhur me organizimin, proceduren dhe programin e qendrimit.

Siç jua kam paraqitur ne letren time te 29 majit 1987 dhe siç u ra gjithashtu dakord gjate konsultimeve te bera deri me tani, mbledhja nuk do te miratoje dokumente zyrtare, por vetem nje komunikate me karakter teknik qe do te informoje mbi mbajtjen e mbledhjes, çeshtjet qe ishin objekt i shkembimit te mendimeve dhe mbi ate qe do te konstatohet pergjithesisht dhe do te bihet dakord. Sigurisht, te gjitha çeshtjet per te cilat do te bihet dakord ne menyre unanime ne mbledhjen e mini-

strave do te mund te perfshihen ne komunikate.

Me lejoni, i nderuari Shoku Minister dhe i dashur koleg, te shpreh bindjen time se mbledhja e ministrave te Puneve te Jashtme, e para ne historine e marredhenieve midis vendeve ballkanike do te jete e efektshme dhe e frytshme dhe do te kontribuoje ne zhvillimin e vazhdueshem te bashkepunimit shumepalesh ne Ballkan, ne perputhje me nevojat aktuale te vendeve tona dhe me frymen e kohes. Perfitoj nga ky rast per te shprehur bindjen time se marredheniet dhe bashkepunimi midis dy vendeve tona do vazhdojne te zhvillohen me sukses dhe per t'ju derguar urimet e mia me te mira per begatine e vendit tuaj dhe per suksesin e perpjekjeve tona te perbashketa per forcimin e bashkepunimit dhe mirekuptimin midis gjithe vendeve ballkanike

Ju lutem pranoni, i nderuari Shoku Minister, siguri-met e konsiderates sime me te larte.

Nenshkruar: Raif Dizdareviç

RENDI I DITES

1.Hapja e mbledhjes

2.Zgjedhja e kryetarit

3.Miratimi i rendit te dites

4.Shkembimi i mendimeve mbi idete,rruget dhe mundesite per zhvillimin e bashkepunimit shumpalesh ne Ballkan ne te gjitha fushta ku interesat e vendeve Ballkanike perputhen dhe ku nevojat jane te perbashketa.

5.Miratimi i komunikates xx perfundimtare

6.Mbyllja e mbledhjes

MBLEDHJA E MINISTRAVE TE PUNEVE TE JASHTME
TE VENDEVE BALLKANIKE

BEOGRAD, 24-26 shkurt 1988 26 shkurt 1988

KOMUNIKATE E PERBASHKET

Me iniciativen e Republikes Socialiste Federative te Jugosllavise, nga data 24-26 shkurt 1988 ne Beograd u mblodhen ministrat e Puneve te Jashtme te vendeve ballkanike.

Mbledhjen e pershendeti kryetari i Kryesise se Republikes Socialiste Federative te Jugosllavise.

Mbledhjes iu derguan mesazhe nga kryetaret e shteteve dhe te qeverive te vendeve ballkanike dhe nga Sekretari i Pergjithshem i Kombeve te Bashkuara.

Ne mbledhje moren pjese ministri i Puneve te Jashtme te RPS te Shqiperise Reis Malile, ministri i Puneve te Jashtme te RP te Bullgarise Peter Mlladenov, ministri i Puneve te Jashtme te Republikes se Greqise Karolos Papulias, ministri i Puneve te Jashtme te RS te Rumanise Ioan Totu, ministri i Puneve te Jashtme te Republikes se Turqise Mesut Yillmaz dhe Sekretari Federativ per Punet e Jashtme te RSF te Jugosllavise Budimir Lonçar, i cili u zgjodh kryetar i mbledhjes.

Ne nje atmosfere konstruktive, ministrat shkembyen mendime mbi idete, rruget dhe mundesite per zhvillimin e bashkepunimit shumepalesh ne Ballkan ne te gjitha fushat, ku interesat e vendeve ballkanike perputhen dhe ku nevojat jane te perbashketa, duke patur parasysh permasat politike, financiare, kulturore, humanitare etj.

Nisur nga interesat dhe nevojat objektive te vendeve ballkanike per te forcuar bashkepunimin e gjithanshem shumepalesh ne rajon, per te forcuar respektin, mirekuptimin dhe besimin reciprok, ministrat vune ne dukje interesin dhe gatishmerine e vendeve te tyre per te kontribuar ne zhvillimin dhe bashkepunimin midis vendeve ballkanike. Ministrat theksuan se kjo mbledhje perben nje kontribut te rendesishem per uljen e tensionit dhe per krijimin e nje atmosfere miqesore e dialogu e cila i sherben gjithashtu paqes dhe sigurimit ne rajonin tone, ne Evrope dhe ne bote.

Nisur nga parimet e respektimit te plote te sistemeve te ndryshme politike, social-ekonomike te vendeve ballkanike, te pavaresise, te sovranitetit, integritetit te tyre territorial, paprekshmerise se kufijve, te drejtave te barabarta, mosnderhyrjes ne punet e brendshme dhe interesit reciprok, ministrat rane dakord te bejne perpjekje te reja per te zhvilluar nje bashkepunim shumepalesh dhe te gjithanshem si dhe marredhenie reciproke midis vendeve ballkanike. Ata shprehen bindjen e tyre se zhvillimi i metejshem i bashkepunimit shumepalesh dhe i marredhenieve dypaleshe mund te arrihet vetem me nje pune kembengulese, me perpjekje te vazhdueshme dhe me nje afrim gradual dhe realist te te gjitha vendeve ballkanike, duke patur parasysh se permiresimi i marredhenieve dypaleshe do te kete nje ndikim pozitiv ne bashkepunimin gjitheballkanik. Ne kete kuader ata vune ne dukje me kenaqesi te veçante zhvillimet pozitive te koheve te fundit ne marredheniet dypaleshe te disa vendeve ballkanike, te cilat kane kontribuar gjithashtu ne atmosferen pozitive te kesaj mbledhjeje.

Ministrat shprehen gatishmerine e tyre per te konsoliduar me tej paqen dhe sigurimin ne Ballkan.

Ne mbledhje vemendje iu kushtua propozimeve per kthimin e Ballkanit ne nje zone pa arme berthamore dhe kimike. Duke patur

parasysh qendrimet e ndryshme per keto çeshtje u ra dakord se nje shqyrtim i metejshem eshte i nevojshem.

Propozimi per mbajtjen e nje mbledhje te kryetareve te shteteve ose qeverive te vendeve ballkanike u diskutua te shqyrtohet me vone kur te jene krijuar kushtet e pershtatshme.

Ministrat i kushtuan nje vemendje te veçante çeshtjeve te bashkepunimit ekonomik midis vendeve ballkanike. Ata vune ne dukje se ekzistojne interesa te perbashketa per zgjerimin e bashkepunimit ekonomik.

Ministrat theksuan ne menyre te veçante nevojen per shfrytezimin me te madh te mundesive te zhvillimit te bashkepunimit shumepalesh ne fushat e tregtise, perfshire shkembimin e mallrave dhe sherbimet, tregtine ne zonat kufitare etj., transportin, industrine, turizmin, aktivitetet bankare, energjetiken, shkencen dhe teknologjine, bujqesine dhe burimet ujore, telekomunikacionin, mjedisin rrethues, shendetesine, kulturen, sportet dhe informacionin

U nenvizua rendesia e aspektit humanitar te bashkepunimit ne rajonin e Ballkanit.

U shpreh pikepamja se pakicat kombetare ne vendet ballkanike, ne territoret e te cilave ato ekzistojne, duhet te jene nje faktor kohezioni, stabiliteti, marredheniesh miqesore, dhe bashkepunimi.

U nenvizua domosdoshmeria e bashkepunimit ne luften kunder terrorizmit dhe tregtise ilegale te narkotikeve dhe armeve.

U shpreh deshira dhe gatishmeria e pergjithshme per te vazhduar iniciativat e ndermarra ne kete mbledhje.

Per kete qellim ministrat rane dakord ne parim qe mbledhjet e ministrave te Puneve te Jashtme te vendeve ballkanike

te mbahen periodikisht.

Ministrat theksuan nevojen per mbajtjen e mbledhjeve te rregullta te zyrtareve te larte te caktuar nga Ministrite e tyre, mbledhja e pare te mbahet mundesisht perpara gjysmes se dyte te vitit 1988 ne Sofje per te studjuar te gjitha propozimet dhe per te bere koordinimin per veprimtarite e metejshme ne te gjitha fushat, duke perfshire mundesine e mbajtjes se mbledhjes se ardhshme te ministrave te Jashtem.

Ministrat rekomanduan mbajtjen e nje mbledhjeje te ministrave te Ekonomise ose te Tregtise se Jashtme ne Turqi me 1988.

Ata rekomanduan gjithashtu qe te mbahet nje mbledhje e ministrave te Transportit ne Jugosllavi, para fundit te vitit 1988.

Ata rekomanduan te mbahet nje mbledhje ne Rumani per te shqyrtuar mundesite e bashkepunimit ne prodhimin industrial duke perfshire edhe transferimin e teknologjise.

Ata rekomanduan gjithashtu qe te mbahet nje mbledhje e dyte e eksperteve qeveritare ne nivelin e duhur mbi mbrojtjen e mjedisit ne Bullgari gjate vitit 1988.

Ministrat nenvizuan dobine e ngritjes ne Athine te nje Instituti Kerkimor per bashkepunimin ekonomik. Kjo ide do te perpunohet me tej ne takimin e pare te zyrtareve te larte, per ta bere ate operative, mundesisht perpara fundit te gjysmes se pare te vitit 1989.

Duke mbeshtetur bashkepunimin ballkanik ~~dhe~~ me nivel joqeveritar, ministrat rekomanduan qe te inkurajohen kontaktet e njerezve nga te gjitha fushat e jetes, si deputete, akademike, gazetare, etj., nepermjet Komiteave ekzistuese te mirekuptimit Ballkanike, ku ka te tille, ose perms.....

Ministrat rane dakord te mbajne kontakte me qellim qe te kontribuojne bashkerisht ne bashkepunimin shumepalesh midis vendeve ballkanike, ne dobi te secilit vend si dhe te forcimit te besimit reciprok, te fqinjesise se mire dhe te marredhenieve miqesore midis vendeve te tyre, mbi nje baze realiste dhe me perspektive.

Mbledhja autorizoi Jugosllavine qe te informoje Organizaten e Kombeve te Bashkuara per rezultatet e mbledhjes.

Ministrat shprehen kenaqesine per menyren se si u zhvilluan punimet e mbledhjes se ministrave te Puneve te Jashtme te Ballkanit dhe i shprehen mirenjohjen e tyre qeverise se RSF te Jugosllavise per mikpritjen e saj te ngrohte qe tregoi ndaj pjesemarresve ne kete mbledhje.